

VENDIM
Nr. 454, datë 26.7.2018

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“SISTEMIM-ASFALTIM I UNAZËS SË QYTETIT, FAZA I”, BASHKIA MALIQ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim-asfaltim i unazës së qytetit, faza I”, Bashkia Maliq.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Maliq.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “truall”, me sipërfaqe 350 m², me vlerë të përgjithshme 621 250 (gjashtëqind e njëzet e një mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 621 250 (gjashtëqind e njëzet e një mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Maliq, planifikuar në buxhetin e saj.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Maliq.
 6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Maliq, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.
 8. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Maliq.
 9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Maliq, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Maliq të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
 10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Maliq të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
 11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Maliq dhe Bashkia Maliq për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT
 “SISTEMIM-ASFALTIM I UNAZËS SË QYTETIT, FAZA I”, BASHKIA MALIQ

Nr.	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e truallit/m ²	Çmimi i truallit/lekë	Vlera e përgjithshme/lekë	Lloji i dokumentit
1	Sanaber Agolli Liri Agolli Muhamare Agolli Repubilkë Agolli Leonart Agolli Arjan Agolli Alma Agolli	2573	1/206	200	1775	355 000	Vërtetim pronësie
2	Tahir Agolli Razije Agolli Vergjinush Agolli Zhaneta Agolli Shqiperie Agolli	2573	1/328	123	1775	218 325	Vërtetim pronësie
3	Pavlo Mentor Agolli Vergjina Agolli Dhimitri	2573	1/329	27	1775	47 925	Vërtetim pronësie
	TOTALI			350		621 250	